

VENDIM
Nr.351, datë 14.3.1998

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE PËR
RRJEDHOJË EDHE NGA AJO E KRYETARIT TË KËSAJ GJYKATE Z.RUSTEM GJATA**

Në mbështetje të neneve 1/b, 2/c dhe 9 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë, që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", ndryshuar me ligjet nr.8151, datë 12.9.1996, nr.8220, datë 13.5.1997, nr.8232, datë 19.8.1997 dhe nr.8280, datë 15.1.1998, mbi bazën e vendimit të datës 28.1.1998 të Komisionit Shtetëror të Kontrollit të Zyrtarëve dhe Personave të tjerë, që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe për rrjedhojë edhe nga ajo e Kryetarit të kësaj Gjykate z.Rustem Gjata.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.